



Datë: 20.04.2026

A.nr.2042/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2042/2025, të datës 17.12.2025, të parashtruar nga ankuesja K.Sh, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.2042/2025, e datës 17.12.2025, e parashtruar nga ankuesja K.Sh.

A r s y e t i m

Ankuesja, K.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 17.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër protokolli Nr.01/1080, të datës 05.09.2025, për pozitën e punës Administrator në Gjykatën Supreme, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 17.12.2025, **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, ka shpallur Konkursin me numër protokolli Nr.01/1080, i protokolluar më datë 11.09.2025, për pozitën e punës Administrator në Gjykatën Supreme, me klasë të pozitës Drejtues i lartë; grupi Q; klasa Q2, , me afat aplikimi nga data 12.09.2025 deri më 11.10.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6)kandidatë përfshirë edhe ankuesen, e cila së bashku me katër (4) kandidatë tjerë ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, duke u konsideruar si kandidatë që kanë plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, ankuesja sipas shkresave të lëndës dhe thënieve si në ankesë nuk ka marrë pjesë në fazat tjera të vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 17.11.2025, ka publikuar Njoftimin përfundimtar të rezultateve nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, nga i cili njoftim rezulton se si kandidate e suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur V.C me 74.6 pikë të përgjithshme.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar procedurën e rekrutimit për pozitën Administrator i Gjykatës Supreme, mbi pretendimin ankimor se nuk ka marrë pjesë në testin me shkrim pasi që konkursi përkatës i punësimit është përcjellë me shkelje ligjore. Tutje, shton se nuk ka hyr në testin me shkrim sepse KPMSHCK-ja ka anuluar konkursin për pozitën Administrator në Gjykatën Supreme-Dhoma e Posaçme. Kërkon nga Këshilli që të konstatoj ligjshmërinë e konkursit me numër protokoll Nr.01/1080, të datës 05.09.2025, për pozitën e punës Administrator i Gjykatës Supreme.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 dhe nenit 39, paragrafi 12 ku përcaktohet se: Neni 27.4: *„4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil...Neni 39.12: 12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.*

Rrjedhimisht, Kolegji mori në zbatim dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më theks të veçantë: **Nenin 14** *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, nenin 103 paragrafi 2, “2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”, si dhe nenin124 paragrafi 1, : “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,”*, dhe si rrjedhojë referuar këtij kuadri ligjor Kolegji vlerëson se më veprimet administrative të ndërmarra në kuadër të procedurës së rekrutimit të pozitës Administrator në Gjykatën Supreme, ankueses nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik, pasi që ankuesja me vet dëshirë e ka braktisur pjesëmarrjen në procedurën përkatëse, andaj, mbi këtë fakt, ankuesja nuk ka përvetësuar legjitimitetin e palës dhe si rrjedhojë në mungesë të legjitimitetit të palës, ankesa A.nr.645/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Mbi rrethanat dhe konstatimin si me sipër, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.2042/2025

Argjenda Sherifi

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, K.Sh;
- Udhëheqësit të Burime Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.